



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË MITROVICË



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, për periudhën kohore Korrik-Shtator 2024.

Arrestohen në Vushtrri dy persona të dyshuar për mashtrim dhe ushtrim të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike

Mitrovicë, 16 korrik 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, njofton opinionin se janë arrestuar në Vushtrri dy persona me iniciale N.M., dhe P.I., me dyshimin se kanë kryer veprat penale “Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike” nga neni 256 i KPRK dhe “Mashtrimi” nga neni 323 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Të dyshuarit, me aktvendim të prokurorit gjenden në ndalim 48 orësh, dhe gjatë ditës së sotme (16 korrik) Prokuroria Themelore në Mitrovicë do të i paraqesë Gjykatës Themelore – Dega Vushtrri kërkesë për caktimin e masës së sigurisë - masës së paraburgimit ndaj të dyshuarve.

Thirrje për bashkëpunim

Mitrovicë, 18 korrik 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, u bënë apel të gjithë personave që janë në cilësinë e të dëmtuarve, duke marrë tretman “mjekësor”, nga personat me iniciale N.M, dhe P.I., të cilët kanë zhvilluar veprimtarinë në biznesin Bio Mulaku në Vushtrri, e që dyshohen për veprat penale “Mashtrimi” dhe “Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike”, të lajmërohen në stacionin më të afërt policor të vendbanimit të tyre për të dhënë deklaratë në cilësinë e të dëmtuarit/dëshmitarit.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës janë duke vazhduar me trajtimin e këtij rasti.

Arrestohet një person për kanosje ndaj gazetarëve të portalit “Mitropol”

Mitrovicë, 26 korrik 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, njofton opinionin se është arrestuar personi i dyshuar me iniciale F.A. nga Vushtrria, me dyshimin se i njëjti ka kanosur gazetarët e portalit “Mitropol” nga Mitrovica, për shkak të një shkrimi të portalit për vendosjen e një mini-parku argëtues në sheshin e Vushtrrisë.

Me këto veprime i dyshuari ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I dyshuari, me vendim të prokurorit gjendet në ndalim 48 orësh.

Pensionohet Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Ismet Ujkani



Mitrovicë, 02 gusht 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë njofton opinionin se ka arritur moshën e pensionimit kryeprokurori i kësaj prokurorie Ismet Ujkani.

Kryeprokurori Ujkani nga 1 janari i vitit 2021 ka ushtruar detyrën e Kryeprokurorit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

Më herët z. Ujkani ka ushtruar detyrën e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda të kësaj prokurorie, prokuror në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë dhe prokuror në Prokurorinë Komunale në Mitrovicë.

Z. Ujkani me angazhimin dhe profesionalizmin e tij ka dhënë kontribut të çmuar në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

Prokurorët dhe stafi administrativ i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e falënderojnë z. Ismet Ujkani për punën dhe kontributin e dhënë.

Prokuroria Themelore e Mitrovicë për pesë ditë pune ka ngritur dyzetetë (48) aktakuza ndaj shtatëdhjetë (72) personave



Mitrovicë, 05 gusht 2024

Për pesë ditë pune, në periudhën 29 korrik - 2 gusht 2024, angazhimi i prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka rezultuar me ngritjen e dyzetetë (48) aktakuzave ndaj shtatëdhjetë (72) personave, për vepra të ndryshme penale.

Aktakuzat e ngritura nga prokurorët e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë janë për veprat penale si në vijim: "Grabitja", "Mashtrimi", "Sulmi", "Kanosja", "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", "Dhuna në familje", "Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare", "Rrezikimi i trafikut publik", "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë", "Vjedhja e shërbimeve", "Vjedhja", "Kontrabandimi i mallrave", "Falsifikimi i dokumenteve", "Cenimi i të drejtave nga sigurimi social", "Marrja e ryshfetit", "Shpërdorimi i pasurisë së huaj", "Mospërfillja e gjykatës", "Lëndimi i lehtë trupor", "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", "Prezantimi i rremë si person zyrtar", si dhe "Vjedhja e pyllit".

Thirrje për bashkëpunim



Mitrovicë, 05 gusht 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, u bënë apel të gjithë qytetarëve, që të mos bien pre e mashtrimeve nëpër platforma të komunikimit, ku nga persona të paautorizuar u kërkohen të dhënat personale të kartelës së llogarive nëpër bankat vendore, dhe luteni që asesi të mos shpërndani këto të dhëna.

Njëkohësisht u bëjmë apel të gjithë qytetarëve që kanë pranuar kërkesa të tilla dhe atyre që kanë shpërndarë të dhënat e llogarive bankare dhe potencialisht janë dëmtuar, që të lajmërohen në stacionin më të afërt policor të vendbanimit tuaj për të dhënë deklaratë në cilësinë e të dëmtuarit/dëshmitarit.

Pensionohet prokurorja e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Zejnije Kela



Mitrovicë, 12 gusht 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë njofton opinionin se ka arritur moshën e pensionimit prokurorja e Departamentit për të Mitur, Zejnije Kela.

Më herët prokurorja Kela, ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë Komunale në Mitrovicë, zëvendës/kryeprokurores në Prokurorinë Komunale në Mitrovicë, dhe prokurores në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë.

Prokurorët dhe stafi administrativ i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë e falënderojnë znj. Zejnije Kela për punën dhe kontributin e dhënë në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

U.d. Kryeprokurori Njazi Rexha vazhdon takimet e hapura me qytetarë



Prokuroria Themelore Mitrovicë

U.d. Kryeprokurori Njazi Rexha
vazhdon takimet e hapura me qytetarë



Mitrovicë, 22 gusht 2024

Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë Njazi Rexha, si pjesë e agjendës javore, e ka caktuar **ditën e enjtë nga ora 13:15 - 15:00**, për takime me qytetarë.

Gjatë këtyre javëve interesimi për takim me U.d. Kryeprokurorin Rexha ka qenë mjaft intensiv. Qytetarët kanë shprehur falënderimin për mundësinë dhe transparencën e treguar nga kreu i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ndërkaq z. Rexha ka shprehur gatishmërinë dhe përkrahjen e institucionit që ai drejton rreth kërkesave të qytetarëve, duke u dhënë edhe sqarimet e duhura.

Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë



Mitrovicë, 26 Gusht 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë brenda javës, nga data 19 - 25 gusht 2024, ka pranuar gjithsej pesëdhjetetë (53) kallëzime penale kundër gjashtëdhjetegjashtë (66) personave.

Gjatë kësaj periudhe janë ngritur gjashtëdhjetenjë (61) aktakuza kundër shtatëdhjetenëntë (79) personave.

Po ashtu, në raste të ndara janë ndaluar pesë (5) persona, si dhe janë paraqitur pesë (5) kërkesa për caktimin e paraburgimit për pesë (5) persona.

Po ashtu, në këtë periudhë janë kryer dhjetë (10) raste me dymbëdhjetë (12) persona, përmes procedurës alternative të ndërmjetësimit.

Aktakuzë ndaj një personi për kanosje të pronarit të portalit Veriu.info



Mitrovicë, 02 shtator 2024

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, njofton opinionin se ka ngritur aktakuzë ndaj personit me initiale L.L., për shkak të dyshimit të bazuar mirë për kryerjen e veprës penale “Kanosja”, nga neni 181 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

I pandehuri L.L., me datë 28 gusht rreth orës 22:00 minuta në Mitrovicë, seriozisht kanos personin me initiale G.M., – pronar i portalit Veriu.info, duke e kanosur se do t’i shkaktoj ndonjë te keqe, për shkak të publikimit që portali që e drejton i dëmtuari kishte bërë për arrestimin e babit të të pandehurit L.L., e duke i shkruar mesazhe kërcënuese, me çka të dëmtuarit i ka shkaktuar frikë e shqetësim emocional.

Me këto veprime, i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Prokurori i Shtetit, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor për veprën e kryera penale dhe ta dënojë sipas ligjit.
